

Merrni kujdes shëndetësor pa frikë

Ju mund të shqetësoheni për rregullin “në ngarkim të publikut”, por mos lejoni që kjo t’ju ndalojë të merrni kujdes shëndetësor!

NYC Health + Hospitals është përkushtuar t’ju ndihmojë të merrni kujdesin shëndetësor që ju meritoni. Këshilltarët tanë financiarë dhe partnerët juridikë mund t’ju përgjigjen pyetjeve tuaja dhe t’ju shpjegojnë nëse rregulli “në ngarkim të publikut” vlen për ju.

	Ndikimi nga “në ngarkim të publikut”	Veprimi që mund të bëni
Marrja e kujdesit shëndetësor në NYC Health + Hospitals.	Marrja e kujdesit shëndetësor nuk është një përfitim publik i identifikuar nga rregulli “në ngarkim të publikut”. Nëse i nënshtroheni rregullit “në ngarkim të publikut”, duke u kujdesur për shëndetin tuaj tani mund të forconi kërkesën tuaj të imigracionit më vonë.	 Merrni kujdes pa frikë!
Medicaid	Shumë imigrantë, përfshirë azilantët, refugjatët, viktimë të caktuara të dhunës dhe njerëz që tashmë kanë kartat e gjelbra nuk i nënshtrohen rregullit “në ngarkim të publikut”. Marrësit e Veprimit të Shtyrë për Fëmijët që Arrijnë (DACA) dhe Statusit të Përkohshëm të Mbrojtur (TPS) kanë të drejtë të marrin Medicaid të financuar nga shteti, që nuk është një përfitim publik i identifikuar nga rregulli “në ngarkim të publikut”.	 Shumica e Njujorkezëve që mund të marrin Medicaid mund të regjistrohen pa shqetësim për rregullin “në ngarkim të publikut”. Merrni faktet mbi situatën tuaj të imigracionit duke telefonuar LegalHealth: 212-659-6188.
Medicaid urgjente, Medicaid për gratë shtatzëna, Plani Thelbësor, Child Health Plus ose një Plan Shëndetësor i Kualifikuar	Këto nuk janë përfitime të identifikuara nga rregulli “në ngarkim të publikut”. Prindërit nuk ndëshkohen për fëmijët e tyre qytetarë që regjistrohen në Child Health Plus ose përfitime të tjera.	 Regjistrohuni pa frikë!
NYC Care ose H+H Options	NYC Care dhe H+H Options nuk janë përfitime publike të identifikuara nga rregulli “në ngarkim të publikut”!	 Regjistrohuni pa frikë!

Nëse nuk e dini se çfarë lloj mbulimi shëndetësor keni, telefononi planin tuaj shëndetësor ose qendrën e kontaktit të NYC Health + Hospitals në 844-NYC-4-NYC (844-692-4692).

Nëse mendoni se ju ose një anëtar i familjes mund të ndikohet, telefononi linjën telefonike të rregullit “në ngarkim të publikut” LegalHealth në 212-659-6188 për një konsultë falas, konfidenciale për imigracionin.

NË NGARKIM TË PUBLIKUT: A vlen për mua?

Ju dhe anëtarët tuaj të familjes keni **kartat e gjelbra**.



Rregulli “në ngarkim të publikut” NUK vlen për ju nëse nuk keni qenë jashtë vendit për më shumë se 6 muaj.

Ju po aplikoni për OSE tashmë keni një nga statuset e mëposhtme: **Shtetësi amerikane, vizë T ose U, azil, refugjat, i mituri imigrant i veçantë, vetë-kërkues sipas Ligjit të Dhunës Kundër Grave (VAWA).**



Rregulli “në ngarkim të publikut” NUK zbatohet për ju. Mund të vazhdoni të përdorni çdo program qeveritar për të cilin ju kualifikoheni. Përfitimet e marra ndërsa ju jeni në këtë status nuk do të llogariten kundër jush, edhe nëse aplikoni për një kartë të gjelbër mbi një bazë tjetër.

Ju ose anëtari i familjes tuaj **planifikoni të aplikoni për një kartë të gjelbër, të aplikoni për një vizë, ose të rinovoni një vizë nga brenda Shteteve të Bashkuara.**



Bëni një konsultë për imigracionin me LegalHealth: 212-659-6188

Ju ende mund të mos t'i nënshtroheni testit “në ngarkim të publikut”, ose përfitimet publike që ju ose anëtarët tuaj të familjes merrni mund të mos i nënshtroheni testit.

Ju ose anëtari i familjes tuaj **planifikoni të aplikoni për një kartë të gjelbër, të aplikoni për një vizë, ose të rinovoni një vizë nga jashtë Shteteve të Bashkuara.**



Bëni një konsultë për imigracionin me LegalHealth: 212-659-6188

Zyrat konsullore të SHBA-së jashtë vendit përdorin rregulla të ndryshme të rregullit “në ngarkim të publikut” kur marrin një vendim. Bëni një konsultë për imigracionin me një profesionist dhe gjithashtu kontaktoni zyrën konsullore të SHBA-së jashtë vendit.

Nëse nuk e dini se çfarë lloj mbulimi shëndetësor keni, telefononi planin tuaj shëndetësor ose qendrën e kontaktit të NYC Health + Hospitals në 844-NYC-4-NYC (844-692-4692).

Nëse mendoni se ju ose një anëtar i familjes mund të ndikohet, telefononi linjën telefonike të rregullit “në ngarkim të publikut” LegalHealth në 212-659-6188 për një konsultë falas, konfidenciale për imigracionin.

Kjo nuk është synuar si këshillë juridike.

Albanian